



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:229825

Datë: 25.11.2024

Numri i dokumentit: 06502944

P.nr.505/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, gjyqtari i vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me bashkëpunëtorin profesional Visar Zeqiri, duke vendosur në çështjen penale, ndaj të pandehurit K. I. nga fshati G. K. L., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.5691/23 të datës 23.10.2023, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbime nga neni 314 par.1 lidhur me par. 6 të KPRK-së, në bazë të nenit 358 par.1, të KPPRK-së dhe nenit 15 par. 1 dhe 17 par. 1, të Ligji për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, ne seancën gjyqësore, me datën 22.11.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr.49/24, e datës 22.11.2024, e lidhur në mes të t'pandehurit K. I. nga fshati G. K. L., dhe të dëmtuarës KEDS-it, me seli në Ferizaj, të cilën me autorizim e përfaqëson Trendelina Kryeziu, e lidhur në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan.

II.HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.5691/23 të datës 23.10.2023.

PUSHOHET procedura penale kundër të akuzuarit K. I., i lindur me datën ..., nga fshati G. K. L., me numër personal-..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbime nga neni 314 par.1 lidhur me par. 6 të KPRK-së, ngase i akuzuari dhe e dëmtuara, kanë arritur marrëveshje të ndërmjetësuar.

III. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj Prishtinë PP.II.nr.5691/23 të datës 23.10.2023, e ka akuzuar të pandehurin Kreshnik Isufi, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbime nga neni 314 par. 1 lidhur me par. 6 të KPRK-së.

Kjo gjykatë ka caktuar shqyrtimin fillestar në çështjen penale kundër të akuzuarit, me datën 31.10.2024, në fillim të shqyrtimit fillestar, gjyqtari pas njoftimit palëve për mundësin e përfundimit të kësaj çështje penale në procedurë të ndërmjetësimit i akuzuari dhe i dëmtuari, u deklaruan se janë të pajtimit, edhe prokurori i shtetit u pajtua që kjo çështje penale të shkojë në procedurë të ndërmjetësimit, ndërsa gjyqtari i vetëm gjykues, ka ndërprerë seancën duke i udhëzuar palët që këtë çështje të mund ta zgjidhin edhe me ndërmjetësim.

Me datën 22.11.2024, në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar ndërmjet të t'pandehurit K. I. nga fshati G. K. L., dhe të dëmtuarës KEDS-it, me seli në Ferizaj, në prani të zyrtarit të ndërmjetësimit të autorizuar nga institucioni i ndërmjetësimit ndërmjetsuesit Faton Morina.

Në seancën e ndërmjetësimit palët kanë arritur marrëveshjen me vullnetin e tyre të plotë dhe nuk kontestojnë asnjëherë nga pikat e lartshënuara për të cilat pajtohen njëzëri.

Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan, me datën 22.11.2024, ka pranuar marrëveshjen e palëve me numër Nd.nr.49/24, të nënshkruar me të datën 22.11.2024, për zgjidhjen e ndërmjetësimit.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenit 358 par.1 nën pika 1.3 të KPPK-së dhe nenit 15 par.5 të Ligji për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN

P.nr.505/23, të datës 22.11.2024

Bashkëpunëtorin profesinal

Visar Zeqiri

Gjyqtari

Avdirrahman Gashi

Udhëzim Juridik: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.